



Tetor 2020

POSTA AJRORE



Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil



Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Kombëtar të Sigurisë në Aviacion, organizoi dhe drejtoi sot mbledhjen e dytë vjetore të këtij komiteti.

Diskutimet u përqëndruan në evidentimin e problematikave aktuale në fushën e sigurisë në aviacion, të cilat kërkojnë angazhim ndërinstitucional, bashkëpunim dhe veprim, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në aviacion dhe përmirësimin e këtij sistemi.

Fal pjesëmarrjes së gjerë dhe diskutimeve konstruktive, ky Komitet ka mundësinë të përmbushë qëllimin e tij në funksion të realizimit të veprimeve konkrete që reflektohen në një risk të ulur dhe masa të zbatuara.

Rrethanat aktuale e bëjnë të domosdoshme marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, por njëkohësisht edhe ruajtjen prej kërcënimeve të reja, ndërkohë që zbatohen masat sanitare të kërkuara nga autoritetet kombëtare shëndetësore.

Falenderohen anëtarët dhe pjesëmarrësit, të cilët pavarësisht kushteve të vështira dhe ngarkesës së tyre profesionale, patën një pjesëmarrje aktive, duke bërë të mundur vazhdimësinë e punës së Komitetit, edhe gjatë situatës së emergjencës shëndetësore për shkak të pandemisë.



Dialogu virtual ECAC/EU për transportin ajror

Aviacioni po ballafaqohet me një krizë të paprecedent për shkak të pandemisë Covid-19: Në dialogun virtual ECAC/EU, u diskutuan sfidat dhe mundësitë për rindërtimin e aviacionit në një botë që ndryshon.

Mbi 350 drejtues të lartë nga rregullatorët, shoqëritë ajrore, aeroportet, ofruesit e shërbimeve të lundrimit ajror, prodhuesit dhe organizatat e industrisë morën pjesë në këtë dialog, i cili u mbajt nën kujdesin e Presidencës Gjermane të Bashkimit Evropian.

Me objektiv për vendosjen e prioritetëve në mbështetje të përmirësimit të aviacionit Evropian në një mjedis që ndryshon, konferenca diskutoi:

- Mbështetja shtesë për industrinë do jetë e nevojshme në muajt dhe vitet e ardhshme për të menaxhuar krizën, e cila do zgjas më shumë se sa ishte parashikuar në fillim.
- Besimi i konsumatorëve duhet të rindërtohet. Siguria në operim (safety) dhe siguria e aviacionit (security) mbeten një prioritet për të gjithë aktorët e këtij sektori, në këtë kohë kur përqëndrimi parësor është vendosur legjitimisht në aspektet ekonomike të kësaj krize.
- Kjo krizë vepron si një katalizator që nxjerr veprime për inovacionin, që çon në përparime në teknologji dhe politika, ku sfidat aktuale mund të kthehen si mundësi. Qëndrueshmëria është si për sfidat madhore ashtu dhe për mundësitë që sektori i transportit ajror ndesh.
- Modernizimi i sistemeve të menaxhimit të trafikut ajror dhe implementimi i paketës "Një Qiell i Vetëm Evropian" do jetë një bllok tjetër për tu ndërtuar, dhe do të luajë një rol thelbësor në zbutjen e impaktit të ndryshimeve klimatike në aviacionin civil.

Mbledhja e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore



Në funksion të ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme në të gjitha nivelet e zhvilluara për përdorimin fleksibël të hapësirës ajrore në Shqipëri, sot u zhvillua mbledhja e rradhës e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare.

Me hyrjen në fuqi së fundmi të Ligjit Nr. 96/2020 "Kodi Ajror i RSH", rregullohet nëpërmjet legjisllacionit primar koncepti i përdorimit fleksibël të hapësirës ajrore- FUA dhe sanksionohet krijimi i Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare me përfaqësues nga autoritete civile dhe ushtarake të aviacionit, nën drejtimin e Autoritetit të Aviacionit Civil.

Përdorimi Fleksibël i Hapësirës Ajrore, një koncept i implementuar në të gjithë vendet e Bashkimit Evropian, po gjen zbatim edhe në vendin tonë. Ky koncept mundëson plotësimin e kërkesës së publikut për transport ajror dhe nevojat në rritje për shërbime të trafikut ajror, duke u bazuar në principin themelor sipas të cilit hapësira ajrore është një e mirë që duhet alokuar në baza ditore, bazuar në kërkesat e përdoruesve.

Komiteti i Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore Shqiptare, me funksione koordinuese civilo/ushtarake, nëpërmjet definimit të politikave të hapësirës ajrore kombëtare dhe ndarjes së strukturave të paracaktuara të kësaj hapësire, mundëson realizimin e FUA-s në nivel strategjik, për t'i hapur rrugë alokimit të vazhdueshëm të hapësirës ajrore bazuar në kërkesë dhe përdorimit në kohë reale të saj, duke lejuar operime të sigurta të trafikut ajror operacional dhe të përgjithshëm.



Inspektim në Tirana International Airport

Autoriteti i Aviacionit Civil kreu një inspektim në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), në kuadër të realizimit të funksioneve të tij mbikqyrëse. Objekt i inspektimit ishte verifikimi i zbatimit të indikatorëve të performancës nga ana e këtij ofruesi. Aeroportet në mbarë botën përpiqen t'u ofrojnë udhëtarëve të tyre shërbim cilësor dhe të sigurt. Një faktor kyç për të pasur sukses në bërjen e një aeroporti të besueshëm dhe efikas është matja e performancës në drejtim të indikatorëve si koha e pritjes, hapësira, kontrolli i sigurisë dhe kufirit, cilësia e shërbimeve dhe mjedisi. Me anë të inspektimeve mbi indikatorët e


performancës, sigurohemi që masat në përdorim mbeten të dobishme. Kjo lejon vlerësimin e nivelit të shërbimit në një aeroport dhe krahasimin e tij me standardet e industrisë. Gjatë këtij aktiviteti monitorues u inspektua fizikisht aeroporti edhe për të verifikuar se sa efektivisht po veprohet në parandalimin e përhapjes së COVID-19. Autoriteti i Aviacionit Civil ka besimin se duke respektuar të gjitha masat dhe protokollet në fuqi, aeroporti do të luajë një rol qendror në ringjalljen e ekonomisë duke lidhur shtetet me njëri - tjetrin, në mënyrë që sektori i transportit të kryejë rolin e tij jetësor ekonomik.



Komiteti i Sigurisë në Operim

Në kuadër të monitorimit të sigurisë së aviacionit civil, u mbledh Komiteti i Sigurisë në Operim (safety) në AAC, me qëllim analizimin e ngjarjeve të aviacionit civil. Duke monitoruar nivelet e sigurisë në industrinë e aviacionit, AAC-ja mund të masë nëse rreziqet e sigurisë janë duke u vlerësuar në mënyrë të duhur dhe të identifikojë fushat në të cilat mund të përmirësohet siguria. Raportimi i ngjarjeve kontribuon në masë të madhe në identifikimin reaktiv dhe proaktiv të rreziqeve të sigurisë dhe ndikon në përmirësimin e masave të sigurisë.

Raportet e ngjarjeve trajtohen në mënyrë konfidenciale për të pasur raportim të plotë dhe të lirë nga komuniteti i aviacionit dhe për të mbrojtur identitetin e individit, në përputhje me Urdhrin e Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë Nr.173, datë 12.04.2019 "Për Raportimin dhe Ndjekjen e Ngjarjeve në Aviacionin Civil në Republikën e Shqipërisë". Numri i ngjarjeve të raportuara pesë vitet e fundit 2016 – 2020, përfshirë trendin e raportimit për 6 mujorin e parë 2020 paraqitet në grafikonin djathtas.



SISTEMET API/PNR NË SHQIPËRI

Në dy takimet e mbajtura gjatë muajëve tetor, nëntor 2020, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Autoritetit të Aviacionit Civil, ALBCONTROL SHA, Tirana International Airport dhe të shoqërisë ajrore Air Albania shqyrtuan së bashku hapat praktikë që do ndërmerren në bashkëpunim me linjat ajrore që operojnë për/nga Aeroporti Ndërkombëtar të Tiranës, për implementimin e sistemeve API/PNR në Shqipëri, pas miratimit të Ligjit nr. 20/2020 Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", Ligjit nr.121/2020, datë 7.10.2020 "Për ratifikimin e memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës lidhur me bashkëpunimin për përdorimin e informacioneve për udhëtarët" dhe diskutimeve për projektregulloren "Për përpunimin e të dhënave të regjistrimit të rezervimit për pasagjerët", që pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Implementimi i sistemeve API/PNR në Shqipëri siguron përputhshmërinë me Standardet 9.5, 9.6 të Aneksit 9 – Lehtësirat (ICAO) dhe zbatimin e dispozitave për komunikimin e të dhënave për pasagjerin (API) që përmbahen në Direktivën e Këshillit 2004/82/EC dhe Direktivën e BE 2016/681 për PNR.

Një mesazh për Tetorin Rozë nga Zonjat e AAC

Në këtë muaj të rëndësishëm për sensibilizimin për shëndetin e gruas, siç është Tetori rozë, zonjat e AAC u bashkuan në një foto simbolike për të rikujtuar se diagnostikimi në kohë shpëton jetën.

Duhet të jemi sot dhe në çdo muaj të kujdesshme ndaj shëndetit tonë dhe të kryejmë kontrollet e përshtatshme si ekografitë e gjirit, mamografi dhe vetëkontrollin periodik.



Osman Maloku flet për shërbimin In-flight Made in Albania

I përfshirë familjarisht në biznesin e përgatitjes së ushqimit që shërbehet gjatë fluturimit ajror komercial (In-flight Catering) Shef Osman Maloku njihet gjerësisht në komunitetin e aviacionit civil shqiptar dhe jo vetëm, si një profesionist i zoti, që i ka kushtuar këtij biznesi pothuajse gjithë jetën e tij. Krenar për emrin dhe namin e mirë që gëzon, ai pranoi me kënaqësi të ndaj me lexuesit e Postës Ajrore të Autoritetit të Aviacionit Civil (AAC), disa prej momenteve më të shënuara në jetën dhe aktivitetin e tij si i pari shqiptar që ndërtoi dhe që vazhdon me sukses punën si drejtues i Cateringut nën emrin In-flight Catering Service International (ICSI) <http://catering.al/>



Shef Osman Maloku me stafin e tij

Përsëritet Shef, së pari, shumë faleminderit që pranuat të jepni këtë intervistë, që me sa dimë nuk ndodh shpesh me njerëzit që punojnë në “vijën e dytë” të veprimtarive në aviacionin civil ndërkombëtar dhe le të kthehemi pas në vite, për t’i njohur lexuesit kur dhe si nisi Cateringu juaj, a e kujtoni menunë e parë, si ishte ajo?

Po dhe unë ju falenderoj shumë për mundësinë që më dhatë, që të komunikoj dhe ndaj me publikun, disa prej kënaqësive dhe vështirësive që kam pasur në gati 30 vite biznes në fushën e përgatitjes së ushqimeve për udhëtarët e linjave ajrore. Marrëdhënia ime me këtë biznes ka nisur në vitin 1991. Unë isha një kuzhinier në Forcën Ajrore të Ushtrisë që gjendet këtu pranë objektit ku unë tashmë kam ngritur këtë biznes. Sapo kishte nisur të dëgjoheshin fjalët privat, privatizim dhe disa prej shokëve të punës u larguan për të nisur profesione të tjera. Ndërsa unë qëndrova aty deri sa dëgjova për themelimin e një shoqërie ajrore të përbashkët shqiptaro-austriake midis Albtransport dhe Tyrolean Airways me emrin kuptimplotë “Albanian Airlines” në fillim të vitit 1992 dhe u paraqita për të punuar. Ishte me fat që pasi u punësua menjëherë kompania më dërgoi për specializim afatshkurtër jashtë vendit. Në të vërtetë unë nuk kisha njohuri për përgatitjen e ushqimeve për pasagjerët në fluturim dhe e vlerësova shumë mundësinë që mu dha. Kam ndjekur me shumë vëmendje çdo proces pune, menu-të, recetat, përbërësit, paraqitjen, kategoritë, masat e sigurisë në përgatitje, gjatë transportit dhe dorëzimit. Eksperiencia e kolegëve të Tyrolean Airways në Innsbruck- Austri dhe e De Ster - Amsterdam ka mbetur si pikë referimi për mua. Lidhur me pyetjen se si ka qënë menu-ja e parë, ju siguroj se ajo ishte e jashtëzakonshme. Imagjinoni, në aq pak hapësirë sa lejon tabakaja të arrish të japësh më të mirën. Pasagjerët e Albanian Airlines thoshin shpesh me kënaqësi, vetëm qumësht dallandsheje nuk gjendet në bordin e avionit, se gjithçka tjetër gjendet. Kam marrë shumë urime në atë fillim dhe shumë më shumë në vitet që pasuan.

Sa e vështirë ka qënë për ju të afirmoheni në një fushë që në Shqipëri pothuajse nuk njihet, cilat janë disa prej sfidave që keni pasur në këto vite?

Po siç e përmenda dhe më lartë unë sinjerisht e konsideroj vetëm me fat që u gjenda në kohën e duhur, në vendin e duhur. E them dhe me krenari që jam nga të parët në mos i pari që i hyri këtij biznesi. Ju pyesni a ka pasur vështirësi?! Po sigurisht që ka pasur vështirësi. Imagjinoni një njeri që ishte mësuar me gatime si pilaf, makarona apo gjellëra të tjera tradicionale për efektivat ushtarake dhe që tani do ti duhej të përgatiste ushqime krejtësisht të panjohura për tryezat tona. Ishte sfidë më vete. Mendoni pastaj stafin që gjithashtu nuk e kishte fare idenë e kësaj pune dhe që unë duhet ta mësoja, ta ndihmoja, ta kontrolloja në çdo hap, për çdo gatim. Po e them përsëri me krenari, ishim të etur për të mësuar. Kishim gjithë vullnetin për të mësuar dhe kështu jemi rritur edhe profesionalisht. Mësuam të përgatisim ushqime jo vetëm për linjat ajrore që kryenin fluturime të rregullta, por edhe ato charter apo dhe taksi. Natyrisht ishim dhe të rinj në atë kohë, por nuk e lamë kohën të rridhte kot. Mësuam dhe ja ku jemi. Do kemi mundësi të ecim së bashku, të vizitojmë ambientet brenda godinës ku do takojmë personelin dhe ju do shikoni me sytë tuaj se si kryhen aty proceset për përgatitjen e ushqimeve për pasagjerët.

Si ka qënë ecuria e biznesit tuaj në kushtet e pandemisë?

Ehh, ky është një hall më vete! Kush e kishte imagjinuar një situatë të tillë? Natyrisht që ndërprerja, kufizimet e fluturimeve dhe reduktimi i lëvizjes së pasagjerëve e ka rënduar gjendjen financiare si kudo dhe në këtë veprimtari. Ka gjithmonë e më pak kërkesa për Katering nga shoqëritë ajrore e megjithatë mbahemi. Me shumë vështirësi, por shpresoj se do ja dalim. Që kur filloi pandemia e COVID-19, puna ka rënë, por nuk kam larguar njeri nga puna. Jam kujdesur që të gjej treg për produktet tona dhe kështu përmes sakrificave uroj dhe shpresoj që të mbijetoj derisa ti kthehemi normalitetit.

Sa i rëndësishëm është ushqimi dhe pijet për pasagjerët në një fluturim ?

Do thosha se ushqimi që ofrohet në bordin e avionit nuk është vetëm një vakt i mirë për ata që udhëtojnë, por është dhe një kënaqësi për ata që e shijojnë teksa fluturojnë për të shkuar në destinacionin e dëshiruar. Vërtet racionet shërbehen në masë e volum të kufizuar në bord, pasi aq e lejojnë mundësitë, por për ne këtu qëndron dhe bukuria e punës dhe sfida për një Chef që të dalloj nga të tjerët. Kur shijon një ushqim të mirë edhe frika e lodhja e udhëtimit ikin si me magji, nuk ndihen hiç, madje dëshiron të kthehesh në fluturim përsëri, pse jo!

Cilat janë kërkesat për ushqimet që shërbehen në bordin e avionit?

Kërkesat për ushqimin që shërbehet në fluturim lidhen jo vetëm me përbërësit dhe shijet, por lidhen sidomos me pastërtinë, higjenën dhe sigurinë. Si pasagjeri që udhëton në Bussines Class ashtu dhe ai në Economy Class në fund të fundit duhet garantuar për pastërtinë dhe sigurinë e ushqimit që konsumojnë. Mund të mos jetë i shijshëm për dikë, por është problem serioz nëse ushqimi nuk është i pastër apo është çënuar siguria gjatë proceseve të kryera deri në sjelljen e tij për konsumim. Po një kërkesë më vete është dhe ushqimi që përgatitet për ekupazhin fluturues. Ushqimi për Kapitenin ashtu i ndryshëm nga ai i Ndihmësit. Kjo për arsye sigurie. Po kështu ka kërkesa për ata pasagjerë që janë me diabet apo sëmundje të tjera për të cilët kërkohet kujdes i veçantë, për të mos i rrezikuar jetën. Tjetër gjë është kur na kërkohet të përgatisim ushqime për sportistët, artistët apo udhëheqësit e shtetit duke përfshirë këtu edhe ata që vijnë me ekip kuzhinierësh me vete. Më ka ndodhur që Sheik apo Kancelar të huaj të kërkojnë të provojnë ushqim tradicional shqiptar ndërsa marrin rrugën e kthimit për në atdheun e tyre. E kam bërë me shumë përgjegjesi dhe kënaqësi gatimin për ta dhe jam ndjerë i lehtësuar kur kam marrë urime për ushqimin e servirur.



A keni pasur raste që të shërbeni vet gjatë ndonjë fluturimi, cilat janë mbresat?

Po, kam pasur disa raste të tilla. Kjo ka ndodhur psh. kur punoja për Albanian Airlines dhe në bord kanë qënë futbollistët e ekipit kombëtar. Në një rast tjetër është kryer një fluturim inaugural nga Tirana për në Bruksel, vajtje-ardhje dhe kapiten ka qënë Elgin Zajmi, një pilot shqiptar i suksesshëm. Kam marrë shumë urime për ushqimet dhe pijet e serviuara. Janë kujtime të paharruara dhe për hir të së vërtetës pas atyre prezantimeve jam bërë mik me shumë prej atyre që kanë qënë në bord, në udhëtim me mua.



Cila është menu-ja që ofroni, a ka diçka nga kuzhina shqiptare e gatimit në menunë tuaj?

Siç e kam përmendur më herët, ushqimi ynë është i standardizuar, i njëjtë me atë të shumë linjave ajrore që operojnë sot në botë. Krahas ushqimeve të njohura për udhëtarët shqiptar dhe ata të huaj ne kujdesemi që në menu të ketë edhe diçka nga kuzhina jonë shqiptare si byrek, gatime me mish të pjekur, ëmbëlsira (ballokume) sigurisht aq sa e lejojnë kushtet në avion. Ndonjëherë, me kërkesë kemi sjell edhe raki, verë apo konjak të prodhuar nga firmat shqiptare.

Dhe në fund, sa fitimprurës është biznesi i Cateringut?

Ju e latë për në fund këtë aspekt dhe mirë bëtë. Siç erdhi kjo situatë e pandemisë e cila nuk mund të krahasohet as me atë të vitit 1997 ku çdo aktivitet u ndal, unë do thosha se jemi në nivelin më të ulët, gati zero- zero për sa i përket fitimit. Natyrisht që ka pasur periudha të mira, kur puna ecte dhe ne punonin me orar të zgjatur. Unë kam investuar shumë, siç e patë dhe ju gjatë vizitës në mjediset e brendshme të Kateringut. Kam blerë pajisje të posaçme për kuzhinën, soba, frigorifer madje dhe një automjet të posaçëm për transportin e ushqimeve deri në dorëzimin e tyre në avion. Kam investuar për higjenën dhe pastërtinë duke përfshirë dhe masat ndaj COVID-19. Po ashtu dhe për sigurinë e aviacionit pasi jam subjekt i certifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil për furnizimet në fluturim.

Për kënaqësinë time dhe jo vetëm, kam krijuar dhe një muze të vogël ku çdo vizitor mund të shoh se si ka qënë ecuria e këtij biznesi në vite. Ju ftoj ta shikojmë së bashku

Edhe njëherë, faleminderit që ma dhatë këtë mundësi.

Intervista u përgatit nga: B. Hazizaj dhe E. Saliaj

Takim virtual i ekspertëve për hetimin e aksidenteve ajrore dhe incidenteve

Hetues dhe ekspertë për hetimin e aksidenteve ajrore dhe incidenteve nga Shtetet Anëtare të ECAC, organizatat vëzhguese dhe partnere u takuan virtualisht për herë të parë, pasi takimet e planifikuara për këtë vit u shtynë për 2021.

Nën drejtimin e kryetarit të sapoemëruar të Grupit të Ekspertëve të ECAC për Hetimin e Incidenteve dhe Aksidenteve Ajrore, Z. Crispin Orr - Dega e Hetimit të Aksidenteve Ajrore në UK, pjesëmarrësit diskutuan sfidat për kryerjen e hetimeve të aksidenteve ajrore gjatë pandemisë COVID-19 dhe masat e përshtatura për menaxhimin e risqeve dhe nënvizuan se është e rëndësishme që puna të vazhdohet. Përfaqësues të industrisë dhe të rregullatorëve gjithashtu sollën një qasje të brendshme sesi industria po ndryshon si rezultat i pandemisë dhe ndikimet për menaxhimin e sigurisë në operim (safety).

Gjatë seksioneve në dy ditë të gjysëm, pjesëmarrësit dëgjuan përditësimet në hetimet aktuale, të tilla si humbjen totale të kontrollit të një avioni elektrik në Holandë, hetimet komplekse të një avioni të lehtë në një aksident në Irland, raportin përfundimtar të shpërthimit të motorrit të avionit të Air France A380 dhe humbjes së një tjetër avioni në Greoland, dhe përditësime lidhur me kthimin në shërbim të avionit Boeing 737 Max. Shtetet Vëzhguese si Singapori dhe SHBA, organizatat vëzhguese EASA, Komisioni Evropian, EUROCONTROL dhe ICAO, sollën përditësime në zhvillimet aktuale dhe prioritet aktuale dhe veprimtaritë.

Grupi gjithashtu shqyrtoi veprimtaritë e tij dhe diskutoi ambicien dhe zhvillimet për projekt programin e punës për periudhën 2022-2024, duke përfshirë përfshirë ngjarjet në terren dhe ngjarjet e ardhshme siç është seminari i planifikuar për sistemet e avionëve pa pilot (UAS).

Burimi: ECAC, Tetor 2020



Në këtë numër BULETINI MUJOR TETOR 2020

- Mbledhja e Komitetit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil
- Dialogu virtual ECAC/EU për transportin ajror
- Mbledhja e Komitetit të Politikave të Menaxhimit të Hapësirës Ajrore
- Komiteti i Sigurisë në Operim Sistemet API/PNR në Shqipëri
- Osman Maloku flet për shërbimin In-flight Made in Albania
- Takim virtual i ekspertëve për hetimin e aksidenteve ajrore dhe incidenteve

KONTAKT

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

ZYRA QENDRORE
Rr. "Sulejman Delvina" P.O Box 205
Tiranë, Shqipëri
TEL.: +355 4 225 12 20
WEB: www.aac.gov.al
EMAIL: info@aca.gov.al

Sektori Për Të Drejtat e Pasagjerit

TELEFON: +355 42 381 959
+355 44 539 959
EMAIL: pax@aca.gov.al

Redaktoi:

Z. BUJAR HAZIJAJ - Koordinator Për Të Drejtën Për Informim
EMAIL: BujarHazijaj@aca.gov.al

ZNJ. EDLIRA SALIAJ - KËSHILLTARE PËR MEDIAN
EMAIL: EdliraSalijaj@aca.gov.al

Media Sociale



facebook.com/AlbanianCAA



[autoriteti.aviacionit.civil](https://twitter.com/autoriteti.aviacionit.civil)